**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PUKË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Pukë, më 22.10. 2024**

**Nr. 1855/12 prot:**

## VENDIM

**Nr. 44 , datë 16.10. 2024**

"PËR NJË SHTESË NË VKB NR 47 DATË 29.12.2023,PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026"I NDRYSHUAR

Këshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e datës 16.10. 2024, në mbeshtetje të nenit 27, neni 54 gërma "dh" të ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar , të ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërise" i ndryshuar;ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"i ndryshuar;ligjit 10296 date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"i ndryshuar ;ligjit 97 datë 07.12.2023 "Për Buxhetin e vitit 2024";Udhëzimin të Ministrisë Financave nr 9 datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.1 datë 24.01.2024."Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024" ,shkreses nr. 11788 datë 4.9.2024" te Ministrise se Fiancave ;VKB nr 47 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtarë 2024-2026 të Bashkisë Pukë"i ndryshuar, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga administrata e bashkisë dhe propozimin e kryetarit të Bashkisë;

## V E N D O S I

1. Miratimin e një shtesë në VKB nr 47 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Pukë" ,të ndryshuar ,si më poshtë:

***SHTOHET:***

*Në 000 lekë*

| Nr | Emërtimi i strukturës | Kod Prog | Kapitull | Llog.Ekonomike | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 600 (paga) | 601(Sig Shoqërore) | |
| 1 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | 01110 | 01 | 6122.194 | 1500 | 7622.194 |
| 2 | Sport dhe Argëtim | 08130 | 01 | 150 | 50 | 200 |
| 3 | Cerdhja ditore | 10430 | 01 | 100 | 20 | 120 |
| TOTALI | | | | 6372.194 | 1570 | 7942.194 |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit . 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore".
4. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.

Vota te vlefshme gjithsej 12
Vota pro 12 , vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon **GJOKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PUKË

29.10.24 H. Teleshi Për ndjekje

1855/4
28.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 727/1 prot.

Shkodër, më 28.10.2024

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 44, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë

**KËSHILLI BASHKIAK PUKË**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 37, pika 1, shkronja "b", neni 54, shkronja "dh", neni 55 pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", neni 23, pika 1, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë", të ndryshuar, të VKM nr. 503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë 31.05.2023", të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", të VKB Pukë nr. 47, datë 29.12.2023 "Për miratimin programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 dhe buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Pukë", të ndryshuar, të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë nr. 1896/3 prot., datë 22.10.2024 "Dërgojmë Vendimet e Këshillit Bashkiak Pukë të datës 16.10.2024", shqyrtoi *VKB Pukë nr. 44, datë 16.10.2024 "Për një shtesë në VKB nr. 47, datë 29.12.2023 Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026, të ndryshuar"*, me shtesë plani në buxhet në shumën 7 942 194 lekë me burim transferimi nga qeveria për mbulimin e rritjes së pagave sipas shkresës së MFE nr. 11788 prot., datë 04.09.2024 "Dërgohet fondi për rritjen e nivelit të pagave, sipas kufirit minimal".

Për sa më trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks +355 2224 2705, e-mail: Prefekti.Shkoder@mb.gov.al